



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:176814

Datë: 30.09.2024

Numri i dokumentit: 06232394

C.nr.1617/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, gjyqtarja Diora Bajrami, në çështjen juridike kontestimore të paditësve N.K., H.K., S.N., M.H. dhe M.Th. që të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim e përfaqëson av. M.B. nga Deçani kundër të paditurës M.A.Sh.T. me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimin e diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguar, vlera e kontestit 13.398 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 30.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve S.N. dhe N.K. nga Prizreni, kundër të paditurës M.A.Sh.T. me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Prishtinë, për shkak të kompensimit të diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguar.

II. DETYROHET e paditura, që paditësve S.N. dhe N.K. në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, tua paguaj :

1. Paditësit S.N. për periudhën kohore prej datës 01.08.2018 e deri me dt. 26.05.2021, apo për 34 muaj (për çdo muaj shumën prej 117.18 euro në shkallë prej 27% të pagës bazë prej 434 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguaj shumën prej 3984.12 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 10.08.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
2. Paditësit N.K. për periudhën kohore prej 01.10.2020 deri më datë 26.05.2021, apo për 8 muaj (për çdo muaj shumën prej 117euro në shkallë prej 27% të pagës bazë prej 434 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej 936 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 10.08.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III.REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve S.N.dhe paditësit N.K. përtej shumës së gjykuar si në pikën II. të këtij dispozitivi të aktgjykimit, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit

dhe atë paditëses S.N. i refuzoi shumën prej 1727.88 euro, paditësit N.K. i refuzoi shumën prej 117 euro.

IV. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesa e paditësit H.K. nga Prizreni me të cilën ka kërkuar të “ *DETYROHET e paditura që për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri më datë 26.05.2021 apo për 48 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.73 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 434.11 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t’ia paguajë shumën prej 2.675 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 10.08.2021, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm*”.

V. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesa e paditësit M.H. nga Prizreni me të cilën ka kërkuar të “ *DETYROHET e paditura që për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri më datë 26.05.2021 apo për 48 muaj (për çdo muaj shumën prej 82.46 euro, në shkallë prej 19% të pagës bazë- 434.11 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t’ia paguajë shumën prej 3958.08 euro të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 10.08.2021, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm*”.

VI. KONSTATOHET e tërhequr padia e paditësit M.Th. nga Prizreni, e paraqitur kundër të paditurës M.A.Sh.T. me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguar.

VII. DETYROHET e paditura, që paditësve, t’ua kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 256.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit N.K. nga Prizreni, H.K., nga Prizreni S.N., nga Prizreni, M.H. nga Prizreni, dhe M.Th. nga Prizreni, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av.M.B. nga Deçani, pranë kësaj gjykate me datë 10.08.2021, kanë parashtruar padi, kundër të paditurës M.A.Sh.T. me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimin e diferencës së pagës së kualifikimit të pa paguar.

Në padi, pala paditëse ka theksuar se paditëset janë të punësuar pranë Institucionit Arsimor Q.B Nënë Tereza në cilësinë e mësimdhënësve, ku secili punonjës i arsimit veç e veç kanë përvojë pune në institucionet arsimore në kohëzgjatje mbi 10 (dhjetë) vite. Inë të diplomuar në Fakultetin Filozofik, Makinerisë, Psikologji, SH.L.P Mesimit Klasor, Shkolla e Mesme Profesionale, dhe kanë kualifikimin bachelor respektivisht kanë lidhur kontratë pune në afat të pacaktuar me të paditurën – M.A.Sh.T. me seli në Prishtinë me ç’rast paditësit gëzojnë titullin e punës mësimdhënës, dhe janë të licencuar si mësimdhënës. Andaj në bazë të larcekurave kërkojnë që të aprovohet kërkesëpadija e paditësve që në emër të kompensimit t’ia paguaj 27% të pagës të kualifikimit pa shkëputje nga puna secilit paditës veç e veç.

Me parashtrësën e dt. 05.07.2022 paditësit përmes të autorizuarit të tyre kanë precizuar kërkesën ashtu që në emër të kompensimit të diferencës së pagesës shtesë për kualifikim kanë kërkuar që paditësit N.K. në pagën bazë prej 434.11 euro në muaj, ndërsa shtesën prej 27% e

kësaj page apo shuma prej 117.00 euro e paditura nuk ia ka paguar nga data 01.09.2020 deri me datë 26.05.2021, e që janë gjithsej 9 muaj, në tërësi shuma e pa paguar e cila detyrohet e paditura të ia paguaj paditësit është $9 \times 117 = 1.053.00$ euro. Paditësi H.K. realizon pagën bazë prej 442.26 euro në muaj, ndërsa shtesën prej 27% e kësaj page apo shuma prej 119.41 euro për secilin muaj, e paditura ia paguan pjesërisht dhe atë vetëm shumën prej 63.68 euro, duke i mbetur borxh shumën prej 55.73, nga data 18.04.2017 deri me datë 26.05.2021, gjithsej 48 muaj, e që janë gjithsej 9 muaj, në tërësi shuma e pa paguar e cila detyrohet e paditura të ia paguaj paditësit është $48 \times 55.73 = 2.675.00$ euro. Paditësi S.N. realizon pagën bazë prej 442.26 euro në muaj, ndërsa shtesën prej 27% e kësaj page apo shuma prej 119.41 euro e paditura nuk ia ka paguar nga data 18.04.2017 deri me datë 26.05.2021, e që janë gjithsej 48 muaj, në tërësi shuma e pa paguar e cila detyrohet e paditura të ia paguaj paditësit është $48 \times 119 = 5.712.00$ euro. Paditësi M.H. realizon pagën bazë prej 434.11 euro në muaj, ndërsa shtesën prej 19% e kësaj page apo shuma prej 82.46 euro e paditura nuk ia ka paguar nga data 18.04.2017 deri me datë 26.05.2021, e që janë gjithsej 48 muaj, në tërësi shuma e pa paguar e cila detyrohet e paditura të ia paguaj paditësit është $48 \times 82.46 = 3958.08$ euro, Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

Ndërsa me parashtresën e dt. 28.08.2024, e autorizuar e paditësve ka deklaruar se për paditësin M.Th. është tërhequr padia, ngase për periudhën e kërkuar ka rezultuar se paditësi në vitin 2017 ka dalë në pension andaj tërhiqen nga kërkesa.

E paditura, në përgjigjen në padi të dhënë me dt. 10.08.2022 e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/ të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar. Më tej ka theksuar se pretendimi i paditësit se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësi nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësi ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, ashtu që i janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par. 6.1. të Ligjit për Procedurën Administrative dhe me këto veprime të paditurës i shkaktojnë shpenzime të mëdha, sepse obligohen të paguajnë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore, gjithashtu kërkesa e paditësve është parashkuar. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 dhe 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune, si mësimdhënëse pranë Q.B “ Nëna Terezë” në cilësi të mësimdhënësve. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësve iu takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar si dhe

nëse kërkesa e paditëses për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit është parashkruar.

Në këtë drejtim, gjykata nga kontrata e punës nr. 3/7-1048-309 e datës 06.07.2020 rezulton se paditësi N.K. është e punësuar tek e paditura- Edukator në konvikt, kualifikimi i paditësit është kualifikim universitar në nivelin baçellor, respektivisht i njëjti ka të përfunduar fakultetin në Universitetin e Prishtinës, dhe ka marrë titullin Profesor i Pedagogjisë fakti i vërtetuar nga diploma me numër 970, e datës 03.12.2007, e lëshuar në emër të paditësit, ndërsa nga vërtetimi nr. 128/2021 e dt. 17.06.2021 lëshuar nga Qendra Burimore “Nënë Tereza” vërtetohet se paditësi ka filluar të punoj në këtë qendër që nga data 01.10.2020 dhe vazhdon të punoj . Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 434.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore nuk i është paguar diferenca në emër të kualifikimit.

Nga kontrata e punës e datës 14.09.2020 rezulton se paditësi H.K. ka qenë i punësuar tek e paditura- mësimdhënës i praktikës profesionale nga data 01.01.2012-31.08.2015, kualifikimi i paditësit është kualifikim universitar në nivelin baçellor, respektivisht i njëjti ka të përfunduar fakultetin e makinerisë në Universitetin e Prishtinës, dhe ka marrë titullin inxhinier i diplomuar i makinerisë, fakti i vërtetuar nga diploma me numër 348/1, e datës 06.07.2000, e lëshuar në emër të paditësit, ndërsa nga vendimi nr. 2-3898 i dt. 27.11.2017 lëshuar nga Ministria e Arsimit vërtetohet se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me dt. 27.11.2017 pasi që paditësit i është njohur e drejta në pension të personave me pa aftësi të përhershme.

Nga kontrata e punës nr. 3/1048-63 e datës 06.03.2016 rezulton se paditësi S.N. është e punësuar tek e paditura- Interpretues i gjuhës së shenjave, kualifikimi i paditësit është kualifikim universitar në nivelin baçellor, respektivisht i njëjti ka të përfunduar fakultetin në Kolegjin Fama dhe ka marrë titullin Profesor i Arteve në Psikologji fakti i vërtetuar nga diploma me numër 425/0714, e datës 30.07.2014, e lëshuar në emër të paditësit, ndërsa nga vërtetimi nr. 118/2021 e dt. 09.06.2021 lëshuar nga Qendra Burimore “Nënë Tereza” vërtetohet se paditësi ka filluar të punoj në këtë qendër që nga data 26.04.2000 dhe vazhdon të punoj. Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 434.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore nuk i është paguar diferenca në emër të kualifikimit.

Nga kontrata e punës nr. 3-7/1048-301 e datës 14.02.2020 rezulton se paditësi M.H. është e punësuar tek e paditura- Instruktor i gjuhës së shenjave që nga data 14.02.2020, i njëjti ka titullin Asistent Klase pasi që ka të përfunduar shkollimin për Asistent Klase dhe Instruktor i Gjuhës së Shenjave (120 kredi), lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe Shoqatës Kosovare të shurdhërve Bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 434.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore nuk i është paguar diferenca në emër të kualifikimit.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se *“shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet*

apo caktohet në të". Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që "nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit". Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se "mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%". Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që "për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008", vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësve t'ia bëjë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontrata e punës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, paditësve nuk ua ka paguar diferencën në bazë të kualifikimit apo licencimit.

Në këtë drejtim paditësi S.N. sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësja përfiton ngritje prej 27% të pagës bazë 434 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësit për çdo muaj t'ia paguaj diferencën e mbetur prej 117.18 euro apo diferencën e mbetur, nga data 01.08.2018 deri më datë 26.05.2021, apo për 34 në shumë të përgjithshme prej 3984.12 euro, e llogaritur në $37 \times 117.18 = 3984.12$ euro.

Sa i përket paditësit N.K. gjykata e detyroi të paditurën që paditësit për çdo muaj t'ia paguaj diferencën e mbetur prej 117 euro apo diferencën e mbetur, nga data 01.10.2020 deri më datë 26.05.2021, apo për 8 muaj në shumë të përgjithshme prej 936 euro e llogaritur në $8 \times 117 = 936$ euro.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata vendosi duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: "*Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*", andaj ka vendosur si në pikën nën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese si në pikën nën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që "*Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia*".

Sa i përket pjesës refuzuese për paditësin N.K. gjykata gjeti se në bazë të vërtetimit nr. 128/2021 e dt. 17.06.2021 lëshuar nga Qendra Burimore “Nënë Tereza” vërtetohet se paditësi ka filluar të punoj në këtë qendër që nga data 01.10.2020 dhe jo siç ka kërkuar paditësi me padi kompensimin mbi bazën e kualifikimit edhe për muajin shtator 2020, pasi që në këtë periudhë paditësi nuk ka pasur raport kontraktual me të paditurën andaj, iu refuzua kërkesa për 1 muaj dhe atë për periudhën 01.09.2020 e deri me dt. 31.09.2020 apo në shumë prej 117 euro.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese për paditësin S.N. gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësi padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 10.08.2021, ndërsa kërkesa e tij ka qenë për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit për periudhën 18.04.2017 e deri me dt. 26.05.2021. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësve iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 18.04.2017 deri më datë 31.07.2018, *po ashtu paditësit ia njohu kompensimin mbi bazën kualifikimit apo licencimit në pagën bazë të cilën e realizon paditësi dhe atë në shumën prej 434.00 euro, duke u bazuar në listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditëses e që është shuma prej 434.00 euro, dhe jo siç është kërkuar nga paditësi në shumën prej 442.41 euro. Andaj, mbi këtë bazë, gjykata refuzoi të pabazuar kërkesën e paditësit sikurse në pikën nën III. të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë duke e minusuar shumën e kërkuar në raport me pagën bazë të kërkuar nga paditësi në shumë prej 442.41 euro dhe asaj që paditësi e realizon e që është në shumë prej 434.00 euro, si dhe mbi bazën e parashkrimit për periudhën prej 18.04.2017 e deri me dt. 31.07.2018, pra shuma e tërësishme e pabazuar është në lartësi prej 1727.88 euro.*

Ndërsa sa i përket paditësit M.H. gjykata ka gjetur se sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, dhe atë diplomë të Shkollës Normale, diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike, diplomë universitare 3 dhe 4 vjet dhe diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë), në këtë drejtim paditësi ka ofruar provën – certifikatën e vitit 2015 e lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe Shoqatës Kosovare të shurdhërve përmes së cilës paditësi ka marrë titullin Asistent Klase dhe Instruktor i Gjuhës së Shenjave, e cila nuk i përgjigjet kriterëve të kualifikimit shkollor siç i përcakton neni 4 i vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008, për të fituar të drejtën e kompensimit mbi bazën e kualifikimit apo licencimit andaj, edhe u refuzua në tërësi kërkesa e tij në shumë prej 3958.08 euro.

Ndërsa sa i përket paditësit H.K. gjykata gjeti se nga vendimi nr. 2-3898 i dt. 27.11.2017 lëshuar nga Ministria e Arsimit vërtetohet se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me dt. 27.11.2017 pasi që paditësit i është njohur e drejta në pension të personave me pa aftësi të përhershme, në këtë drejtim, në rastin konkret paditësit i ka përfunduar marrëdhënia e punës me dt. 27.11.2017, rrjedhimisht për shkak se paditësit i është përfunduar marrëdhënia e punës, të njejtit nuk i takon kompensimi mbi bazën e kualifikimit për periudhën e kërkuar dt. 27.11.2017- 26.05.2021, ndërsa për periudhën 18.04.2017 e deri me dt. 27.11.2017 sa ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, gjykata e vlerësoi afatin 3 vjeçar për parashkrimin e

kërkesës në fjalë, dhe erdhi në përfundim se paditësit iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 18.04.2017 deri më datë 27.11.2017, andaj të njëjtit iu refuzua në tërësi kërkesa e në shumë prej 2.675 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 10.08.2021, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në anën tjetër sa i përket pikës VI të dispozitivit të aktgjykimit, gjykata me dt. 28.08.2024 nga përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse, av. M.B. ka pranuar parashtrësën e datës 21.08.2024, përmes së cilës ka njoftuar gjykatën se e tërheqin padinë dhe kërkesëpadinë për paditësin M.Th. nga Prizreni, në këtë çështje juridike kontestimore.

Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet që të konstatohet e tërhequr padia e paditësit, në përputhje me nenin 261 të LPK-së. Kështu, në nenin 261 par. 1 të LPK-së theksohet që *“paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”*. Pastaj, me nenin 261 par.2 të po këtij neni thuhet, *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritore.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 156.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 100.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 256 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë dhe mbi bazën e suksesit në procedurë. Për më tepër nuk mund të kërkohet kompensim për secilën parashtrësë të deponuar në gjykatë, duke qenë se parashtrësja gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me nenin 399 dhe 398 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.1617/2021, të datës 30.09.2024

Gjyqtarja

Diora Bajrami

Numri i lëndës: 2021:176814
Datë: 30.09.2024
Numri i dokumentit: 06232394

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.